



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 111, datë 06.03.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONIN
E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 244
DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË
KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatës, znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 244 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 244, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i kandidimit është përcaktuar deri më datë 14.06.2023. Kjo procedurë është shoqëruar me njoftimin përkatës dhe publikimin e vendimeve respektive të shpalljes së vendeve të lira dhe hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), gjyqtare në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Me Vendimin nr. 57, datë 07.02.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ndër të tjera ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 10. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi.”

5. Më datë 12.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtoi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Më datë 19.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së.

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

10. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

11. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

11.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

11.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatës në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, konkretisht në *Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*), në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (*tashmë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë*) dhe në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Durrës (*tashmë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës*), ku ka kryer stazhin profesional. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 1688/1 prot., datë 23.03.2023, siç do të përshkruhet më poshtë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr.1065 prot., datë 10.03.2023 siç do të përshkruhet më poshtë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr.2304/1 prot., datë 13.03.2023 dhe përmes komunikimit elektronik të datës 06.04.2023, siç do të përshkruhet më poshtë¹.

¹ Të dhënat e marra nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Vlorë dhe Tiranë janë ato të marra në kuadër të verifikimit të kriterëve formale të kandidatës për pozicionet 499, 501 dhe 502.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

12. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “*përvojës profesionale minimale*”.

13. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar*”.

14. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023.

15. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2005, ndërkohë ajo është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Durrës, për periudhën 17.09.2004 deri më 03.10.2005, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Vlorë, detyrë të cilën e ka ushtruar për periudhën deri më 14.11.2011. Në vijim ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Tiranë, deri më datë 10.02.2020. Nga data 10.02.2020 deri më 10.02.2023 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjirokastrë. Më datë 10.02.2023 kthehet pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Tiranë, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht.

16. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datë 12.07.2001 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2005.

Me dekret nr. 4319, datë 17.09.2004 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Durrës.

Me dekret nr. 4655, datë 03.10.2005 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Vlorë.

Me vendim nr. 281, datë 14.11.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Tiranë.

Me vendim nr. 68, datë 06.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjirokastrë komandohet në pozicionin “Këshilltar Ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjirokastrë, për një periudhë 2 vjeçare.

Me vendim nr. 52, datë 08.02.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor përsëritet komandimi në pozicionin “Këshilltar Ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një periudhë 2 vjeçare.

Me vendim nr. 52, datë 27.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi para afatit të komandimit në pozicionin “Këshilltar Ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe nga data 10.02.2023 rikthehet në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 19 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

18. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura për një periudhë të paktën 15 vjet.

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që kandidatja referuar dhe urdhrit nr. 403 datë 16.10.2012; nr. 406 datë 23.10.2012; nr. 406/1 datë 21.11.2012; nr. 406/2 datë 11.12.2012; nr. 12 datë 22.01.2013; nr. 406/3 datë 04.02.2013; nr. 43 datë 07.05.2013; nr. 43/1 datë 10.06.2013 të kryetarit të gjykatës është vendosur që të gjykoj çështje civile, familjare dhe penale gjatë të gjithë periudhës së stazhit profesional; ndërsa për periudhën mars 2023 e në vijim kjo gjyqtare është pjesë e dhomës civile, seksioni familjar.

20. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidaten rezulton si vijon:

- Urdhri nr. 232, datë 21.11.2011, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. 9, datë 21.01.2013, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. 94, datë 26.09.2013, “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil(Seksioni Tregtar Civil) të gjyqtarës Marinela Nuni ({...})”;

- Urdhri nr. 39, datë 03.03.2015, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. 198, datë 21.11.2016, “Për një ndryshim të urdhrit nr. 39, datë 03.03.2015 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. 27, datë 01.03.2017 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;
- Urdhri nr. 117, datë 10.07.2017 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;
- Urdhri nr. 242, datë 03.12.2019 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

Sipas urdhrave të mësipërm, për vitet 2011 – 2019 kandidatja rezulton e caktuar pranë seksionit civil (tregtar).

Për periudhën mars 2023 e vijim kandidatja është e caktuar në seksionin penal.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për kandidaten rezulton se për periudhën tetor 2004 – dhjetor 2005, ku gjyqtarja znj. {...} ka ushtruar stazhin profesional, ajo gjykuar në të dy seksionet, civil si dhe penal.

22. Sipas informacionit të përcjell nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se; “gjyqtarja {...} për periudhën 20.06.2022-27.01.2023 ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile dhe penale pasi Gjykata e Apelit Vlorë nuk pasur ndarje në dhoma dhe seksione.”

23. Sipas informacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për kandidaten rezulton si vijon:

- urdhri nr. extra, datë 06.01.2006 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezulton pranë seksionit penal);
- urdhri nr. 179, datë 31.01.2007 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezulton pranë seksionit familjar);
- urdhri nr. 1, datë 08.01.2009 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezulton pranë seksionit civil të përgjithshëm);
- urdhri nr. 11, datë 27.01.2011 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezulton pranë seksionit civil);

24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

25. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

26. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

27. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 14.06.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

28. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

29. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

30. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

31. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

32. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 14.06.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

33. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

34. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

III. KONKLUZIONE

35. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 244 datë 24.05.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

36. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraparak kritereve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të kritereve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 244 datë 24.05.2023.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “a” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 244 datë 24.05.2023; “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i tij, z. Klodian Kurushi,

V E N D O S I :

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 datë 24.05.2023.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR